



QENDRA HISTORIKE E FSHATIT DHËRMI

Fshati i Dhërmiut, vlerësohet si një gur i çmuar i kurorës himariote, fshati i “shtëpive të bardha” të vendosura shkallë – shkallë në faqen e malit, i veshur me vlera monumentale, historike, arkitektonike, ambientale, etnografike dhe estetike. Ky fshat shpallet Qendër Historike me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 29, date 20.01.2016. Fshati i vjetër i Dhërmiut vihet në mbrojtje, për t’iu nënshtruar projekteve të rivlerësimit e restaurimit dhe për t’u kthyer në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit ruralo-familjar. Kompozimi urban i fshatit dhe objektet e paçmuara të kultit përbëjnë një potencial zhvillimi ekonomik të shpejtë.



 Qendra historike  Zonë e mbrojtur 1  Zonë e mbrojtur 2

